



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Tessa Tech Prishtina shpk" të datës 21.08.2026 kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (kompjuterë, monitor dhe laptop Marrëveshjes publike kornize te AQP-se me nr. të ref. AQP;UA/2026-24-3927-1-1-1" me nr. të prokurimit 616-26-6616-5-5-8, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Tessa Tech Prishtina shpk" të datës 21.08.2026 kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (kompjuterë, monitor dhe laptop Marrëveshjes publike kornize te AQP-se me nr. të ref. AQP;UA/2026-24-3927-1-1-1" me nr. të prokurimit 616-26-6616-5-5-8.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Tessa Tech Prishtina shpk" (tutje "parashtuesi") me datë 21.08.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (kompjuterë, monitor dhe laptop Marrëveshjes publike kornize te AQP-se me nr. të ref. AQP;UA/2026-24-3927-1-1-1" me nr. të prokurimit 616-26-6616-5-5-8.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

#### **PRETENDIMI 1: MOSPËRGJIGJJA NDAJ GJASHTË SQARIMEVE DHE KATËR NËNPYETJEVE**

Ne kemi dorëzuar plotë trembëdhjetë pyetje sqaruese, kurse AK ka trajtuar vetëm sqarimet 1-5 dhe pjesërisht sqarimin 11. Sqarimet 6, 7, 8, 9, 10 dhe 12 kanë mbetur pa përgjigje, ndërsa te sqarimi 13 AK vetëm ka përsëritur ndarjen buxhetore prej 4,000.00 euro për vitin 2026 dhe 320,000.00 euro për vitin 2027, pa iu përgjigjur nënpyetjeve 13(a)-(d).

Me këtë rast konsiderojmë se nga ana e AK-së janë shkelur nenet 53.4-53.6 të LPP-së dhe neni 24.4(a)-(b) i Rregullores, sepse AK duhej ose ta jepte informatën e kërkuar, ose ta refuzonte me shkrim kërkesën për sqarim. Mospërgjigjja cenon gjithashtu transparencën sipas neneve 7.1 dhe 7.6(ii) të LPP-së dhe detyrimin e nenit 17.12 të Rregullores që dosja të përmbajë informatat e nevojshme për përgatitjen e ofertës.

Injorimi ndaj kërkesave konkrete, nuk është as përgjigje dhe as refuzim i arsyetuar. Përgjigjet ndaj sqarimeve 1-5 nuk mund të zbatohen vetvetiu për sqarimet 6-10, sepse AK nuk ka bërë një lidhje të tillë dhe pozicionet kanë specifikime të ndryshme. Pa këto përgjigje, OE nuk mund ta përcaktojë me siguri produktin, çmimin, planin e furnizimit dhe ekspozimin financiar.

Kërkesa e jonë është që AK të publikojë përgjigje të plota, të numëruara dhe konkrete për sqarimet 6, 7, 8, 9, 10, 12 dhe nënpyetjet 13(a)-(d), njëkohësisht për të gjithë operatorët ekonomikë.

#### **PRETENDIMI 2: ZVOGELIMI I KAPACITETIT TE MEMORIES RAM NGA 32GB NË 16GB - PC MODEL III, 150 COPË**

Aneksi 1 i Marrëveshjes Publike Kornizë kërkon minimum 32GB DDR4, ndërsa Ftesa për Ofertim kërkon minimum 16GB DDR5. AK e ka mbajtur minimumin 16GB duke u mbështetur në mundësinë e zgjerimit të memories në të ardhmen dhe në optimizimin e buxhetit.

Ulja e një minimumi numerik të kornizës shkel nenin 38.2 të LPP-së. Neni 38.5.2 lejon që në mini-tender të përcaktohen vetëm kushtet e veçanta që janë lënë qartë të hapura. Të njëjtin kufizim e vendosin nenet 54.8, 54.21(c) dhe 54.41 të Rregullores; ndërsa nenet 54.23(b), 54.24(b) dhe 54.35 sqarojnë se konkurrenca e mëtutjeshme shërben për plotësimin e termave të lënë të hapur, jo për uljen e një minimumi të fiksuar.

DDR5 është standard më i ri, por standardi dhe kapaciteti janë dy parametra të ndryshëm. Mundësia e zgjerimit në të ardhmen nuk e zëvendëson furnizimin aktual me 32GB dhe do t'i krijonte AK-së shpenzim shtesë. Po ashtu, numri i slotëve nuk e zëvendëson kapacitetin minimal të kërkuar.

Kërkesa e jonë është që specifikimi të korrigjohet në minimum 32GB.

### **PRETENDIMI 3: ULJA E MEMORIES NGA 32GB NË 16GB - POZICIONI PREJ 50 COPEËVE**

Edhe për pozicionin prej 50 kompjuterësh është kërkuar minimum 16GB, ndërsa Marrëveshja përcakton minimum 32GB. Sqarimi nr. 7 nuk ka marrë përgjigje. Për më tepër, emërtimi "PC Model III i Avancuar" nuk figuron në Aneksin 1, i cili njih PC Model I-IV dhe Workstation Model V. Për uljen e memories janë shkelur nenet 38.2 dhe 38.5.2 të LPP-së, si dhe nenet 54.21(c) dhe 54.41 të Rregullores. Për mospërgjigjen janë shkelur nenet 53.4-53.6 të LPP-së dhe neni 24.4 i Rregullores. Emërtimi i paqartë i modelit cenon nenet 27.1 dhe 28.8 të LPP-së dhe nenin 19.4 të Rregullores. Nuk mund të dihet se cili minimum kontraktual zbatohet nëse vetë kategoria e produktit nuk barazohet me një model të Marrëveshjes. Kjo paqartësi rrit rrezikun e interpretimit të ndryshëm gjatë vlerësimit.

Kërkesa e jonë është që memoria të korrigjohet në minimum 32GB dhe AK të sqarojë shprehimisht me cilin model të Aneksit 1 barazohet kategoria "PC Model III i Avancuar".

### **PRETENDIMI 4: KARTELA GRAFIKE 6GB/8GB - MUNGESA E ARSYETIMIT FUNKSIONAL**

Marrëveshja publike kornize përcakton pragu 4GB GDDR6, ndërsa Ftesa kërkon 6GB për 150 kompjuterë dhe 8GB për 50 kompjuterë. AK ka dhënë vetëm një arsyetim të përgjithshëm për nevoja profesionale dhe nuk ka identifikuar aplikacionin ose ngarkesën konkrete që e bën të domosdoshëm pragu e ngritur. Për pragu 8GB nuk është dhënë përgjigje.

Vetë fakti që specifikimi është më i avancuar nuk përbën automatikisht shkelje, sepse neni 1.2 i Marrëveshjes e lejon këtë. Shkelja qëndron te mungesa e lidhjes së dokumentuar me nevojën dhe te ndikimi kufizues: nenet 7.2, 7.3, 7.6(i) dhe (iii), 9.1(iii), (iv) dhe (vii) dhe 28.2 të LPP-së; si dhe nenet 17.17, 19.4 dhe 54.9 të Rregullores. Për mospërgjigjen lidhur me 8GB zbatohen edhe nenet 53.4-53.6 të LPP-së dhe 24.4 i Rregullores.

Ne nuk e mohojmë mundësinë që ndonjë ngarkesë pune të kërkojë 6GB ose 8GB. Mirëpo AK nuk ka treguar se cilat janë ato ngarkesa dhe pse një konfigurim 4GB nuk mjafton për përdorimin e planifikuar. Pa këtë lidhje dhe pa analizë të modeleve të disponueshme, pragu mbetet i paarsyetuar dhe potencialisht kufizues.

Kërkesa e jonë është që specifikimi të riformulohet si minimum 4GB GDDR6 ose më shumë; ose AK të publikojë arsyetimin teknik, aplikacionet dhe ngarkesat konkrete, si dhe analizën e ndikimit të pragut 6GB/8GB në konkurrencë.

### **PRETENDIMI 5: PORTI USB TYPE-C ME SHPEJTËSI FIKSE 10 GBPS**

Ne kemi kërkuar formulimin "minimum 1x USB Type-C" ose "minimum 1x USB Type-C 5 Gbps ose më i shpejtë". AK e ka mbajtur pragu 10 Gbps, me arsyetimin se të gjithë prodhuesit e kanë këtë port në versionet e reja, por pa listuar modele apo analizë tregu. Për pozicionin prej 50 njësive nuk është dhënë përgjigje.

Me kete janë shkelur nenet 7.2, 7.3, 7.6(i) dhe (iii), 9.1(iii), (iv) dhe (vii) dhe 28.2 të LPP-së, si dhe nenet 17.17, 19.4 dhe 54.9 të Rregullores. Për mospërgjigjen zbatohen nenet 53.4-53.6 të LPP-së dhe neni 24.4 i Rregullores.

Porti USB Type-C është lloj konektori, ndërsa 10 Gbps është nivel performance. Modelet afariste mund të kenë USB Type-C me nivele të ndryshme performance. AK nuk ka treguar cilin përdorim konkret nuk e mbulon 5 Gbps dhe as nuk e ka mbështetur pohimin se kriteri plotësohet nga të gjithë prodhuesit.

Kërkesa të riformulohet si minimum 1x USB Type-C, ose minimum 1x USB Type-C 5 Gbps ose më i shpejtë. Alternativisht, AK të publikojë analizën e tregut dhe arsyetimin funksional për 10 Gbps.

### **PRETENDIMI 6: NJËSIA E USHQIMIT - PRAGU FIKS 400W**

Faqe 3 nga 6

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)

Marrëveshja publike kornize kërkon "Power: EU Standard" pa fuqi minimale, ndërsa Ftesa cakton minimum 400W dhe kërkon që kartela grafike të jetë pjesë e konfigurimit origjinal të prodhuesit. AK e ka arsyetuar prapun duke iu referuar përvojës me kartela 4GB dhe njësi ushqimi 180W. Për pozicionin prej 50 njësive nuk është dhënë përgjigje.

Kriteri duhet të vlerësohet sipas neneve 6.1, 7.2, 7.3, 9.1(v) dhe 28.2 të LPP-së dhe neneve 17.17, 19.4 dhe 54.9 të Rregullores. Për mospërgjigjien zbatohen nenet 53.4-53.6 të LPP-së dhe neni 24.4 i Rregullores.

Fuqia nominale e njësisë së ushqimit nuk është tregues i drejtpërdrejtë i performancës dhe as i konsumit real. Dimensionimi varet nga konfigurimi i plotë dhe validimi i prodhuesit. Prandaj, një prag fiks 400W mund të përjashtojë konfigurime OEM të validuara dhe efikase pa sjellë përfitim funksional. Kriteri më i saktë është validimi i prodhuesit dhe niveli i efikasitetit.

Kërkesa e jone eshte të hiqet pragu 400W dhe të kërkohej njësi ushqimi origjinale e prodhuesit, e dimensionuar dhe e validuar për konfigurimin e ofruar, me efikasitet të deklaruar.

#### **PRETENDIMI 7: PROCESORI - KRITERI I PAQARTË DHE JO I UNIFIKUAR**

Marrëveshja e lidh minimumin me "gjeneratën e parafundit në ditën e Ftesës për Ofertim" dhe pranon ndryshimin e emërimit të gjeneratave. AK ka deklaruar se pranon Core i7 Gen 14 ose Core Ultra 7, por nuk ka përcaktuar serinë, platformën dhe mënyrën e ekuivalentimit. Për procesorin e laptopit nuk është dhënë përgjigje.

Me kete kriter janë shkëlur nenet 7.6(iv), 27.1 dhe 28.8 të LPP-së dhe nenet 17.12 dhe 19.4 të Rregullores. Nëse kriteri i lëvizshëm i Marrëveshjes është zëvendësuar me familje të ndryshme pa bazë të qartë, zbatohen edhe nenet 38.2 dhe 38.5.2 të LPP-së dhe nenet 54.21(c) dhe 54.41 të Rregullores. Për mospërgjigjien zbatohen nenet 53.4-53.6 të LPP-së dhe neni 24.4 i Rregullores.

Familjet Core i7 dhe Core Ultra përdorin skema të ndryshme emërimi dhe kanë ndarje të ndryshme për desktop dhe laptop. Pa përcaktim të serisë dhe pa metodë ekuivalentimi, kriteri mund të interpretohet ndryshe para dhe pas dorëzimit të ofertave.

Kërkesa e jonë është që AK të përcaktojë, ndaras për kompjuterë dhe laptopë, familjen, serinë dhe platformën që konsiderohet gjeneratë e parafundit më 12.08.2026, si dhe metodën objektive të ekuivalentimit.

#### **PRETENDIMI 8: NDRYSHIMI I SPECIFIKIMIT PA FORMULARIN B54**

Në përgjigjen e datës 17.08.2026 AK ka deklaruar se kufiri maksimal 17.3 inç i ekranit të laptopit nuk aplikohet. Në të njëjtin dokument ka deklaruar se specifikimet mbeten sipas dosjes dhe se përgjigjet nuk duhet të interpretohen si ndryshim. Formulari B54 dhe versioni i korrigjuar i dosjes nuk janë publikuar.

Ndryshimi pas publikimit duhet të bëhet sipas neneve 23.13 dhe 24.7 të Rregullores, me formularin B54 dhe version të korrigjuar të dosjes. Zbatohen edhe nenet 7.6(ii) dhe (iv), 27.1, 53.6 dhe 53.9 të LPP-së. Në rast të miratimit të kësaj kërkesë, neni 63.1.3(b) i Rregullores e obligon AK-në ta publikojë B54 dhe ta zgjasë afatin; afati i ri duhet të respektojë edhe minimumin e nenit 38.6 të LPP-së dhe të nenit 54.42(a) të Rregullores.

Një përgjigje sqaruese nuk mund ta zëvendësojë instrumentin formal për ndryshimin e dosjes. Përndryshe mbeten dy versione të kundërta: teksti i dosjes dhe përgjigjia. Kjo krijon pasiguri se cili version do të përdoret gjatë vlerësimit.

Kërkesa jone eshte qe AK të publikojë B54, versionin e konsoliduar dhe të korrigjuar të Ftesës dhe specifikimeve, me identifikim të qartë të ndryshimeve, dhe të caktojë afat të ri të mjaftueshëm për ofertim.

#### **PRETENDIMI 9: MOSSQARIMI I PLANIT TË POROSIVE, DORËZIMIT DHE PAGESËS**

Në kërkesën për sqarime, nën numrin 13 janë kërkuar: koha e lëshimit të fletëporosive, ndarja e furnizimit në faza dhe sasi të përcaktuara për secilin vit, afati i pagesës dhe viti i pagesës për pajisjet e dorëzuara

në 2026. AK vetëm ka përsëritur ndarjen buxhetore 4,000.00 euro për 2026 dhe 320,000.00 euro për 2027.

Me këtë janë shkelur nenet 9.2, 9.3, 9.5, 27.1 dhe 53.4-53.6 të LPP-së, si dhe nenet 8.1-8.5, 17.12 dhe 24.4 të Rregullores. Kushtet e furnizimit dhe pagesës janë kushte materiale dhe duhet të jenë të qarta para ofertimit.

Afati i furnizimit është 45 ditë nga fletëporosia, ndërsa pjesa dërrmuese e buxhetit është planifikuar për vitin 2027. Pa plan indikativ, OE nuk mund ta vlerësojë koston e financimit, disponueshmërinë e modeleve, rrezikun e ndryshimit të çmimeve dhe detyrimet ndaj furnitorëve.

Kërkesa jonë është që AK të publikojë planin indikativ të porosive, sasive, dorëzimeve dhe pagesave për 2026-2027, të sqarojë afatin e pagesës dhe të konfirmojë bazën financiare dhe klauzolën për ndarjet e ardhshme sipas nenit 9.3 të LPP-së.

#### **PRETENDIMI 10: ULJA E KOHËZGJATJES SË BATERISË NGA 8 NË 7 ORË**

Aneksi 1 i Marrëveshjes kërkon "Battery Life 8+ hour", ndërsa Ftesa kërkon "Battery Life 7+ hour". Kjo mospërputhje nuk është trajtuar në përgjigjen e AK-së.

Ulja e një minimumi të fiksuar shkel nenet 38.2 dhe 38.5.2 të LPP-së dhe nenet 54.8, 54.21(c) dhe 54.41 të Rregullores. Neni 1.2 i Marrëveshjes lejon specifikime të njëjta ose më të avancuara, jo ulje nën minimum.

Kohëzgjatja e baterisë ndikon drejtpërdrejt në përdorimin në terren. Edhe sikur dallimi të duket i vogël, ai është devijim numerik nga një minimum kontraktual dhe nuk mund të korrigjohet me arsyetim pasues.

Kërkesa e jonë është që specifikimi të korrigjohet në minimum 8 orë.

#### **PRETENDIMI 11: PORTI RJ45 PA ADAPTER DHE TASTIERA US LAYOUT**

Ftesa kërkon port RJ45 të integruar dhe ndalon adapterin, ndërsa Aneksi 1 kërkon vetëm kartelë rrjeti 10/100/1000 Mbps. Po ashtu, Ftesa kërkon tastierë me **numeric pad dhe US Layout**, ndërsa Marrëveshja kërkon vetëm QWERTY. AK nuk ka dhënë arsyetim funksional për këto dy kufizime. Me këto janë shkelur nenet 7.2, 7.3, 7.6(i) dhe (iii), 9.1(iii) dhe (iv) dhe 28.2 të LPP-së, si dhe nenet 17.17, 19.4 dhe 54.9 të Rregullores. Nëse këto kushte nuk janë lënë qartë të hapura, zbatohen edhe neni 38.5.2 i LPP-së dhe nenet 54.35 dhe 54.41 të Rregullores.

Lidhja gigabit realizohet edhe me adapter origjinal të prodhuesit, pa ndryshim të funksionit. Ndaj absolute e adapterit përjashton modele afariste më të holla. Ndërsa gjuha e tastierës përcaktohet në sistemin operativ; prandaj kërkesa për US Layout duhet të lidhet me një nevojë konkrete, jo të vendoset si kufizim i pashpjeguar.

Kërkojme që të pranohet adapteri origjinal i prodhuesit si zgjidhje e barasvlershme për lidhjen gigabit dhe të hiqet kërkesa US Layout, ose AK të japë arsyetim funksional dhe analizë të ndikimit në konkurrencë.

#### **PRETENDIMI 12: EFEKTI KUMULATIV I SPECIFIKIMEVE NË KONKURRENCË**

Kriteret e kontestuara nuk veprojnë të izoluara: kartela grafike 6GB/8GB, USB Type-C 10 Gbps, njësia e ushqimit 400W, kërkesa për konfigurim origjinal, RJ45 pa adapter, US Layout dhe paqartësitë e procesorit zbatohen njëkohësisht mbi të njëjtin konfigurim. Efekti i përbashkët duhet të vlerësohet sipas neneve 6.1, 7.1-7.3, 7.6(i) dhe (iii), 9.1(iii)-(v) dhe (vii) dhe 28.2 të LPP-së, si dhe neneve 17.17, 19.4, 54.9 dhe 54.41 të Rregullores. Një parametër i ngritur mund të jetë i arsyeshëm kur lidhet me nevojë reale. Por disa parametra të ngritur ose të fiksuar njëkohësisht, pa analizë funksionale dhe pa kontroll të tregut, mund ta ngushtojnë mini-konkurrencën të një numër shumë i vogël modelesh. Kjo ë rrit koston dhe e zvogëlon presionin konkurrues mbi çmimin.

Lidhur me pretendimet ankimore, fillimisht duhet sqaruar se ky aktivitet i prokurimit është i ndërlidhur ngushtë me marrëveshjen kornizë të AQP (shih edhe titullin e aktivitetit). Rrjedhimisht është gjetur se kërkesat e vendosura nga njësia kërkuese në dosjen e tenderit nuk janë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen e AQP. Për këtë arsye pretendimet me numër nga 2 deri 12 janë të bazuara respektivisht janë pjesërisht të bazuara prandaj AK duhet të korrigjoj dosjen e tenderuesit duke harmonizuar kërkesat e DT me kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen me AQP. Ndërsa pretendimi me nr. 1 është i pabazuara sepse AK ka kthyer përgjigje sipas LPP.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.08.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.